



Me qëllim të vazhdimësisë së aktivitetit të transmetimit të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale të licencuara nga KPM, të cilave ju përfundon afati i licencave në transmetimin analog, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Zgjatet përkohësisht afati i licencave të transmetimit të TV stacioneve me transmetim tokësor analog, të cilave licenca ju skadon me datën 28 gusht 2019. TV stacionet të cilave ju skadon licenca e KPM-së për transmetim janë: RTK 1, TV 21, KTV, TV Dukagjini, TV Mitrovica dhe TV Festina.
- II. Shfrytëzimi i frekuencave të cilat i kanë në përdorim këta të Licencuar do të jetë i përkohshëm, respektivisht deri në përmbylljen e procesit të kalimit nga transmetimi analog në atë digjital.
- III. Të Licencuarit që janë pjesë e këtij Vendimi do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, të lëshuar më 28 gusht 2009 dhe të njëjtat mbesin të pandryshuara, përfshirë Kushtet Teknike, Formatin e Programit si dhe Zonën e Mbulimit të të Licencuarve.

Arsyetim

- IV. Ligji Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave parasheh mundësinë e ripërtëritjes së licencës në afat 10 vjeçar për TV, mirëpo duke marrë parasysh procesin e kalimit nga transmetimi analog në transmetim digjital nuk është e mundur të bëhet ripërtëritja e tyre, sepse me implementimin e procesit të digjitalizimit duhet të lëshohen licenca për transmetim digjital për TV stacionet të cilat janë të interesuara për këtë lloj transmetimi.
- V. Me qëllim të sigurimit të vazhdimit të aktivitetit të transmetimit i cili është në interes të publikut të gjerë dhe në interes të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale, KPM vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër që e rregullon këtë çështje.


Muja FERATI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave

Ref:1908/1033/KPM/mf
Data: 29 gusht 2019